



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:207617

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05842555

KPPP.nr. 101/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ballkan Petrol” Sh.p.k. me seli në Ferizaj, me numër unik të biznesit 810080036, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Trepça Sh.A., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 376/2023 të datës 11.09.2023 të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 20.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Trepça Sh.A. dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.376/2023, i datës 11.09.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 103,452.72€ (njëqind e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e dy cent).
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.376/2023, i datës 11.09.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, me të cilën është caktuar përmbartimi, sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Ballkan Petrol” Sh.p.k. ndaj debitorit Trepça Sh.A., për detyrimin kryesor në shumën prej 103,452.72€ (njëqind e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e dy cent), për shkak të përmbushjes së detyrimit kryesor.
- IV. DETYROHET debitori “Trepça” Sh.A., që t’ia paguajë kreditorit “Ballkan Petrol” Sh.p.k. shumën prej 325€ në emër të përpilimit propozimit për përmbartim dhe shumën

prej 325€ në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

### A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Ballkan Petrol” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin P.nr.376/2023, të datës 11.09.2023, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr. B-2305929, të datës 30.05.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Trepça Sh.A., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës të lartcekur, të paguaj shumën 103,452.72€ (njëqind e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e dy cent), me kamatë prej 8% nga data 01.07.2023 e deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, ndërsa nëse debitori dështon të paguaj borxhin, i njejtë të realizohet duke i bllokuar mjetet financiare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë bankare të Përmbaruesit Privat, e në qoftë se debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë bankare, të bëhet sekuestrimi i sendeve të luajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton urdhrin për përmbarim, si jo të drejtë dhe të pabazuar ngase kreditori nuk e ka prezantuar faturën origjinale apo kopjen e faturës të vërtetuar në bazë të origjinalit, ashtu siç parashihet në nenin 29 paragrafi 3 LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar, urdhri përmbarimor të ndryshohet dhe kërkesa e kreditorit të refuzohet si e pabazuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit sipas të cilave kreditori nuk i ka paraqitur faturat në origjinal pasi që me propozim për përmbarim ka dorëzuar faturën origjinale dhe dëshmitë e dorëzimit të mallit. Andaj i propozon gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Me parashtresën e datës 24.05.2024, përfaqësuesi i kreditorit ka njoftuar gjykatën që debitori ka përmbushur obligimin sipas faturës B-2305929 dhe për të njëjtën ka bashkangjitur dëshminë e transferit bankar ndërsa ka kërkuar nga gjykata që të mbetet në fuqi urdhëri lidhur me shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji

Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbaruesit Privat Fadil Hoxha, P.nr.376/2023, i datës 11.09.2023, në shumë prej 103,452.72€ (njëqind e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e dy cent) është përmbushur në tërësi. Gjykata erdhi në këtë përfundim, pasi që me parashtresën e datës 24.05.2024, të dorëzuar nga përfaqësuesi i kreditorit gjykata është njoftuar se debitori e ka përmbushur detyrimin kryesor, ndërsa është kërkuar që procedura të vazhdojë vetëm sa i përket shpenzimeve, ndërsa si provë për përmbushjen e detyrimit kryesor është bashkëngjitur transaksioni bankar nga RBKO i datës 29.11.2023.

Gjykata nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga transaksioni i bashkëngjitur nga përfaqësuesi i kreditorit, konstatoi se debitori e ka përmbushur detyrimin për pagesën e borxhit, përkatësisht shumën prej 103,452.72€ (njëqind e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e dy cent), andaj gjykata vlerësoi se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par.1.2, ku përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur efektin, sepse e njëjta është përmbushur nga debitori.

Gjykata në kuptim të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, në të cilën theksohet se *“përveç tarifës së efikasitetit të përmbarimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbaruesit privat dhe kreditorit, tarifat tjera paraprakisht paguhen nga kreditorit dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit”*, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që kreditori në propozimin për përmbarim i ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, i cili propozim është lejuar me urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Fadil Hoxha, P.nr.376/2023, i datës 11.09.2023 . Gjykata vlerësoi se shpenzimet e përmbarimit janë krijuar nga ana e debitorit, pasi që i njëjti detyrimin e tij ndaj kreditorit e ka përmbushur pas inicimit të procedurës përmbarimore dhe zhvillimit të procedurës deri në këtë fazë.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar në tërësi detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: “*Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore*”, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: “*Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera*”, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit si rrjedhojë e përmbushjes në tërësi të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbartimor e lë në fuqi, vetëm sa i përket pjesës së shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit dhe atë shumën prej 325€ në emër të përpilimit propozimit për përmbartim dhe shumën prej 325€ në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 100,000€ e më lartë.

Gjykata në kuptim të nenit 66 par. 4, 71 par.1, nën par. 1.2, nenit 73 par.1 dhe 3 të LPP-së nenit 4 par. 4, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1566/23, datë 20.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.